

WEnerg sh.a.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 -22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionarët e Shoqërisë WEnerg sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **WEnerg sh.a** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, goftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



Teit Gjini

Auditues Ligjor



Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

26 mars 2019

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	7,966,662	3,981,359
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	7,945,522	22,800,305
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	74,627,140	74,627,140
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	40,977,302	58,826,463
Paradhënie dhe shpenzime të shtyra	8	2,152,450	1,689,913
Totali i aktiveve afatshkurtra		133,669,076	161,925,180
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	314,728	406,572
Aktive afatgjata jomateriale	10	732,271,291	768,259,631
Kapitali nënshkruar i papaguar	11	15,435,000	15,435,000
Totali i aktiveve afatgjata		748,021,019	784,101,203
Totali i aktiveve		881,690,095	946,026,383
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	12	45,989,376	60,453,224
Llogari të pagueshme tregtare	13	14,943,962	20,218,889
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	8,219,587	6,838,521
Detyrime tatimore	15	3,274,808	34,570
Të tjera detyrime	16	2,129,359	3,306,265
Totali i detyrimeve afatshkurtra		74,557,092	90,851,469
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	17	334,683,697	385,580,840
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	18	686,628,682	704,426,209
Totali i detyrimeve afatgjata		1,021,312,379	1,090,007,049
Totali i detyrimeve		1,095,869,471	1,180,858,518
Kapitali			
Kapitali nënshkruar		46,000,000	46,000,000
Humbje e akumuluar		(280,832,135)	(223,259,735)
Fitimi i ushtrimit		20,652,759	(57,572,400)
Totali i kapitalit	19	(214,179,376)	(234,832,135)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		881,690,095	946,026,383

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

WENERG SH.A
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	97,735,679	59,357,646
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	964,861	192,643
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(31,907,901)	(35,230,154)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	22	(25,379,381)	(25,577,966)
2) Të tjera shpenzime	23	(6,528,520)	(9,652,188)
Shpenzime të personelit	24	(4,690,248)	(2,711,855)
1) Paga dhe shpërblime		(4,611,846)	(2,666,522)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(78,402)	(45,333)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	25	(36,470,412)	(34,776,449)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(240,134)	(2,446,673)
Shpenzime financiare		6,418,778	(41,957,558)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	27	(46,617,805)	(54,246,010)
2) Shpenzime të tjera financiare	28	53,036,583	12,288,452
Fitimi/(humbja) para tatimit		31,810,623	(57,572,400)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	29	(11,157,864)	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(11,157,864)	-
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/(humbja) e vitit		20,652,759	(57,572,400)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		20,652,759	(57,572,400)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

WENERG SH.A

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali i nënshkruar	Humbjet e akumuluarra	Fitim / (Humbja) e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2017	46,000,000	(201,517,193)	(21,742,542)	(177,259,735)
Transferim në humbje të akumuluarra		(21,742,542)	21,742,542	-
Humbja e vitit			(57,572,400)	(57,572,400)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	46,000,000	(223,259,735)	(57,572,400)	(234,832,135)
Transferim në humbje të akumuluarra		(57,572,400)	57,572,400	-
Humbja e vitit			20,652,759	20,652,759
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin				
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	46,000,000	(280,832,135)	20,652,759	(214,179,376)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i WEnerg sh.a. më 25 Mars, 2019 dhe janë firmosur si më poshtë:



Armand Fehatahaj
Hartues i Pasqyrave Financiare
NIPT: K921180423V
TIRANË - SHQIPËRI



Z Julien Gerald Emile Roche
Administrator
ALBANIA

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
<i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitim / Humbja e vitit	31,810,623	(57,572,400)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	(11,157,864)	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36,470,412	34,776,449
Diferenca kembimi jo nga aktivite operative	(35,186,243)	(11,803,580)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	32,703,944	(13,119,090)
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(462,537)	(189,374)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(19,628,056)	24,091,560
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	34,550,279	(23,816,435)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(390,228)	(147,345)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(390,228)	(147,345)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Rritje/(Rënie) në huatë afatshkurtër	(15,710,900)	77,112,749
Ripagim/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	(14,463,848)	(50,456,687)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(30,174,748)	26,656,062
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	3,985,303	2,692,282
Mjetet monetare në fillim të periudhës	3,981,359	1,289,077
Mjetet monetare në fund të periudhës	7,966,662	3,981,359

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "WEnerg" sh.a është regjistruar pranë QKR me datë 18.09.2009 me NIPT K92118019L. Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Veprimtaria kryesore tregtare e Shoqërisë është planifikim, projektim, financim dhe ndërtim të Hidrocentralit "Dardha" në Pukë si dhe prodhimi i energjisë elektrike.

Kapitali aksionar i Shoqërisë është 46,000,000 lekë i cili zotërohet nga aksionerët e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është Z. Julien Gerald Emile Roche.

Selia qendrore e saj është në adresën : Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Nr. 1, Kati 7, Tiranë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përkufizuar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme (vazhdim)

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/Lek	123.42	132.95
USD/ Lek	107.82	111.10

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyresh	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera AAM	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

është e mundur që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiviteti do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe
kosto e aktivitetit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Njësi ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivitetit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëpasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Aktivitetet jo-materiale të krijuara nga marrëveshja koncesionare janë amortizuar në bazë të periudhës koncesionare.

Aktivitetet e tjera jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.5.1 Marrëveshjet Koncesionare**

Një marrëveshje koncesionare e shërbimeve është një marrëveshje ku një qeveri ose një organ tjetër i sektorit publik (koncesiondhënësi) kontraktin një operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivet e infrastrukturës së koncesiondhënësit si rrugë, ura, tunele, aeroporte, rrjete të shpërndarjes së energjisë, burgje apo spitale. Në këto marrëveshje, koncesiondhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivet, kujt duhet t'ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënës në aktive në fund të afatit të marrëveshjes.

Shoqëria ka njohur aktivet e krijuara nga marrëveshja koncesionare sipas modelit të Aktivit Jomaterial. Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licensën) për t'ia tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivit jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK5 Aktivit afatgjatë materiale dhe aktivet afatgjatë jomateriale.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë. Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjatë materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjatë të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka qira operative.

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5.1 Marrëveshjet Konçesionare

Një marrëveshje konçesionare e shërbimeve është një marrëveshje ku një qeveri ose një organ tjetër i sektorit publik (konçesiondhënësi) kontraktin një operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivet e infrastrukturës së konçesiondhënësit si rrugë, ura, tunele, aeroporte, rrjete të shpërndarjes së energjisë, burgje apo spitale. Në këto marrëveshje, konçesiondhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivet, kujt duhet t'ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënës në aktive në fund të afatit të marrëveshjes.

Shoqëria ka njohur aktivet e krijuara nga marrëveshja konçesionare sipas modelit të Aktivit Jomaterial. Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licensën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivit jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka qira operative.

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mjete monetare në bankë	7,966,662	3,981,359
Në lekë	7,852,837	3,970,657
Në monedhë të huaj	113,825	10,702
	<u>7,966,662</u>	<u>3,981,359</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Klientë	7,945,522	22,800,305
	<u>7,945,522</u>	<u>22,800,305</u>

6. Llogari të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e arkëtueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	74,627,140	74,627,140
	<u>74,627,140</u>	<u>74,627,140</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Tatim në burim	2,559,895	2,786,313
TVSH për t'u rimbursuar	38,417,407	52,928,448
Tatimi mbi fitimin	-	3,111,702
	<u>40,977,302</u>	<u>58,826,463</u>

WENERG SH.A

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

8. Paradhënie dhe shpenzime të shtyra

Në këtë zë janë paraqitur shpenzimet për siguracione të cilat i përkasin periudhave të ardhshme. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime të shtyra	2,001,736	1,689,913
Paradhënie për furnizim	150,714	-
	<u>2,152,450</u>	<u>1,689,913</u>

9. Aktive afatgjata materiale

	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>				
Gjendja më 1 janar 2017	358,336	623,655	415,083	1,397,074
Shtesa				-
Nxjerrje jashtë përdorimit				-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	358,336	623,655	415,083	1,397,074
Shtesa				-
Nxjerrje jashtë përdorimit				-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	358,336	623,655	415,083	1,397,074
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Gjendja më 1 janar 2017	211,974	426,327	233,009	871,310
Amortizimi i vitit	22,593	70,184	26,415	119,192
Nxjerrje jashtë përdorimit				-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	234,567	496,511	259,424	990,502
Amortizimi i vitit	18,074	52,638	21,132	91,844
Nxjerrje jashtë përdorimit				-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	252,641	549,149	280,556	1,082,346
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 31 dhjetor 2017	123,769	127,144	155,659	406,572
Gjendja më 31 dhjetor 2018	105,695	74,506	134,527	314,728

10. Aktive afatgjata jomateriale

	Aktive të krjuara sipas marrëveshjes konçesionare	Të tjera jomateriale	Total
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2017	960,779,280	1,780,040	962,559,320
Shtesa	147,345		147,345
Nxjerrje jashtë përdorimit			-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	960,926,625	1,780,040	962,706,665
Shtesa	390,228		390,228
Nxjerrje jashtë përdorimit			-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	961,316,853	1,780,040	963,096,893
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2017	159,034,152	755,625	159,789,777
Amortizimi i vitit	34,503,595	153,662	34,657,257
Nxjerrje jashtë përdorimit			-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	193,537,747	909,287	194,447,034
Amortizimi i vitit	36,247,955	130,613	36,378,568
Nxjerrje jashtë përdorimit			-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	229,785,702	1,039,900	230,825,602
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor 2017	767,388,878	870,753	768,259,631
Gjendja më 31 dhjetor 2018	731,531,151	740,140	732,271,291

11. Kapitali i nënshkruar i papaguar

Kapitali i nënshkruar i papaguar më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Kapital i nënshkruar i papaguar	15,435,000	15,435,000
	15,435,000	15,435,000

12. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Overdraft	-	40,322,794
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë Societe Generale Albania	21,807,026	-
Interesa të përllogaritura	24,182,350	20,130,430
	45,989,376	60,453,224

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Furnitorë	14,943,962	20,218,889
	<u>14,943,962</u>	<u>20,218,889</u>

14. Llogari të pagueshme afatshkurtra ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime tregtare ndaj palëve të lidhura	7,492,581	5,495,992
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura	727,006	1,342,529
	<u>8,219,587</u>	<u>6,838,521</u>

15. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	24,971	7,517
Detyrime për tatim fitimin	3,125,075	-
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	124,762	27,053
	<u>3,274,808</u>	<u>34,570</u>

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 për Shoqërinë vijojnë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime ndaj punonjësve	2,129,359	3,306,265
	<u>2,129,359</u>	<u>3,306,265</u>

17. Hua afatgjata

Huaja afatgjatë e marrë nga banka Societe Generale Albania më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Hua nga banka Societe Generale Albania-Pjesa Afatgjatë	334,683,697	385,580,840
	<u>334,683,697</u>	<u>385,580,840</u>

18. Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura, afatgjata

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura përfaqësojnë vlerën e marrë hua nga Shoqëria mëmë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Hua nga shoqëria mëmë CN' AIR	686,628,682	704,426,209
	<u>686,628,682</u>	<u>704,426,209</u>

19. Kapitali

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Numri i aksioneve	4,600	4,600
Vlera nominale	10,000	10,000
	<u>46,000,000</u>	<u>46,000,000</u>

Vlera e kapitalit më 31 dhjetor 2018 është 46,000,000 Lekë i zotëruar nga aksionerët Ylliad dhe CN' AIR. 49% e aksioneve zotërohen nga Ylliad dhe 51 % e aksioneve zotërohen nga CN' AIR. Humbjet e mbartura më 31 dhjetor 2018 janë (280,832,135) Lekë. Humbjet e mbartura më 31 dhjetor 2017 janë (223,259,735) Lekë.

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga shitja e energjisë	97,450,861	59,061,615
Të ardhura të tjera	284,818	296,031
	<u>97,735,679</u>	<u>59,357,646</u>

21. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Penalite dhe gjoba të arkëtuara	1,249,966	-
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti operativ	(285,105)	192,643
	<u>964,861</u>	<u>192,643</u>

(Vlerat janë në Lek)

21. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

	<u>31 dhjetor 2018</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	95,011,433
Qarkullim i tatueshëm	2,724,246
Zbritet tarifa e koncensionarit	97,735,679
Shuma e qarkullimit e korrektuar	97,735,679
Sipas Kontabilitetit	-
Diferenca	-

22. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime manaxhimi	22,941,963	24,098,028
Taksa e koncensionit	2,437,418	1,479,938
	<u>25,379,381</u>	<u>25,577,966</u>

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Blerje ujë, energji	284,818	296,031
Qira	2,427,336	2,510,052
Shpenzime mirëmbajtjeje	-	1,005,480
Taksa të ndryshme	407,300	360,300
Shërbime nga të tretë	684,643	1,017,205
Shpenzime sigurimi	1,425,833	940,659
Shpenzime bankare	66,726	93,978
Trajtime të përgjithshme	-	3,094,036
Shpenzime të tjera	1,231,864	334,447
	<u>6,528,520</u>	<u>9,652,188</u>

24. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime për paga	4,611,846	2,666,522
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	78,402	45,333
	<u>4,690,248</u>	<u>2,711,855</u>

25. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime amortizimi	36,470,412	34,776,449
	<u>36,470,412</u>	<u>34,776,449</u>

26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Gjopa dhe dëmshpërblime	240,134	2,446,673
	<u>240,134</u>	<u>2,446,673</u>

27. Shpenzime interesi neto dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet e interesit neto detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime interesi	45,354,764	52,105,963
Të ardhura nga interesat	(13,777)	(2,440)
Shpenzime komisioni Overdraft	1,276,818	2,142,487
	<u>46,617,805</u>	<u>54,246,010</u>

(Vlerat janë në Lek)

28. Shpenzime të tjera financiare

Shpenzimet e tjera financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga kembimet valutore nga aktiviteti financiar	(53,022,260)	(11,803,580)
Të ardhura të tjera	(14,323)	(484,872)
	<u>(53,036,583)</u>	<u>(12,288,452)</u>

29. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
<i>Fitimi para tatimit</i>	31,810,623	(57,572,400)
Total shpenzime të panjohura	45,594,898	54,552,636
Penalitetet, gjopa e dëmshpërblime	240,134	2,446,673
Shpenzime interesi	45,354,764	52,105,963
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	77,405,521	(3,019,764)
Humbje fiskale e mbartur	(3,019,764)	
Rezultati tatimor	74,385,757	
Tatim fitimi @15%	11,157,864	
	<u>20,652,759</u>	<u>(57,572,400)</u>

30. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Ylliad shpk	-	7,492,581	-	5,495,992
Truen	74,627,140		74,627,140	-
Julien Roche		727,006	-	1,342,529
CN' AIR France	-	686,628,682	-	704,426,209
	<u>74,627,140</u>	<u>694,848,269</u>	<u>74,627,140</u>	<u>711,264,730</u>

30. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Ylliad shpk		27,530,356		24,098,027
CN' AIR		33,698,658		33,733,705
	-	61,229,014	-	57,831,732

31. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2018 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

32. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.